



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

Në bazë të nenit 42, 48, 161, 162, 163, 164 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë dhe Strategjisë për kërkime shkencore në UHZ, Ligjit nr. 04 L – 135 për Veprimtari Kërkimore – Shkencore, Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 01/2018 për Parimet e Njohjes së Platformave dhe Revistave Ndërkombëtare me Recension të MASHTI-it, Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë në mbledhjen e mbajtur më datë 28.03.2024, miratoi këtë:

**RREGULLORE  
PËR VEPRIMTARINË KËRKIMORE-SHKENCORE DHE ARTISTIKE**

**Neni 1  
Qëllimi**

1. Qëllimi i kësaj rregullore është:

- 1.1. Promovimi i cilësisë dhe mbështetja e punës kërkimore-shkencore dhe artistike të personelit akademik të rregullt, inkurajimi i ngritjes në karrierë, shpërblimi i përpjekjeve dhe përkushtimi i hulumtuesve shkencorë dhe artistik;
- 1.2. Promovimi i cilësisë dhe mbështetja e punës kërkimore-shkencore të Institutit për Shkencë dhe Arte.

**Neni 2  
Fushëveprimi**

Kjo rregullore zbatohet për personelin akademik të rregullt në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, dhe personelin e Institutit për Shkencë dhe Arte, të cilët publikojnë me emër të UHZ-së.

**Neni 3  
Obligimet e personelit akademik**

Personeli akademik i rregullt i Universitetit është i obliguar të bëjë kërkime shkencore dhe punë kërkimore në përputhje me aftësitë e tyre profesionale dhe obligimet që dalin nga Statuti, Plani Strategjik, Strategjia për Kërkime Shkencore dhe në harmoni me Kodin Etik për kërkime dhe integritet. Çdo anëtar i personelit akademik do të vlerësohet nga mbikëqyrësi një herë në vit për kontributin e tij në veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe artistike.

**Neni 4  
Obligimet e UHZ-së**

Universiteti përkushtohet për krijimin e kushteve të përshtatshme për veprimtari kërkimore-shkencore dhe artistike për të ndihmuar personelin akademik që të arrijë rezultate konkurruese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

## **Neni 5**

### **Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe artistike**

Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe artistike përfshin këto aktivitete:

1. Realizimin e kërkimeve themelore, të avancuara dhe aplikative, si dhe aktiviteteve artistike me qëllim të zhvillimit të veprimtarive kërkimore-shkencor dhe artistike në fushat si biznes, turizëm, agrobiznes, drejtësi dhe arte.
2. Organizimin e konferencave shkencore dhe koncerteve vendore, rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe organizimin e punëtorive dhe seminareve në bashkëpunim me institucionet e tjera në vend dhe jashtë vendit;
3. Bashkëpunimin me ndërmarrjet ekonomike dhe industrinë, si dhe institucionet publike dhe private në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
4. Veprimtarinë botuese të revistave shkencore;
5. Veprimtarit tjera kërkimore-shkencore në fushat që mbulohen me programet studimore në Universitet.

## **Neni 6**

### **Organet përgjegjëse**

Organet/përgjegjësit për veprimtari kërkimore-shkencore dhe artistike janë:

1. Prorektori për Mësimdhënie, Çështje Studentore dhe Kërkime Shkencore;
2. Zyra për Kërkime Shkencore;
3. Koordinatori për kërkime shkencore dhe veprimtari artistike;
4. Grupi për kërkime shkencore dhe veprimtari artistike;
5. Instituti për shkencë dhe arte.

## **Neni 7**

### **Përgjegjësitë e Prorektorit për Mësimdhënie, Çështje Studentore dhe Kërkime Shkencore**

Në përputhje me Strategjinë për Kërkime Shkencore në nivel të institucionit, Prorektori është përgjegjëse për:

1. Koordinimin e aktiviteteve kërkimore-shkencore dhe artistike në Universitet, në pajtim me Misionin dhe Planin Strategjik;
2. Bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e kërkimeve shkencore dhe veprimtarisë artistike;
3. Hartimin dhe monitorimin e zbatimit të planit dhe buxhetit vjetor për punën kërkimore-shkencore dhe artistike;
4. Koordinimin dhe priorizimin e planit dhe aktiviteteve kërkimore-shkencore dhe artistike të propozuara nga Instituti për shkencë dhe arte;
5. Informimin e organeve menaxhuese të Universitetit rreth aktiviteteve kërkimore-shkencore dhe artistike, si dhe përfaqësimin e këtyre aktiviteteve brenda dhe jashtë vendit;
6. Propozimin e politikave, rregulloreve dhe procedurave për rregullimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe artistike.

## **Neni 8**

### **Detyrat e Zyrës për Kërkime Shkencore**

Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe artistike koordinohet nga Zyra për Kërkime Shkencore (ZKSH) në bashkëpunim me Prorektorin dhe Institutin për Shkencë dhe Arte.

1. ZKSH udhëhiqet nga koordinatori për kërkime shkencore dhe veprimtari artistike dhe është përgjegjëse për:
  - 1.1. Botimin e revistës shkencore në nivel të Universitetit;
  - 1.2. Botimin e gazetës studentore;
  - 1.3. Përkrahjen e zhvillimit profesional të personelit akademik;
  - 1.4. Koordinimin e punës së botimit të teksteve universitare sipas Rregullores për Botime;
  - 1.5. Përkrahjen e aplikimeve për projekte të vogla kërkimore kombëtare;
  - 1.6. Mbikëqyrjen e administrimit dhe monitorimin e projekteve të vogla kërkimore kombëtare;
  - 1.7. Mirëmbajtjen e seksionit për kërkime në faqe zyrtare të institucionit;
  - 1.8. Mirëmbajtjen e bazës së të dhënave për kërkime në faqen zyrtare të UHZ-së;
  - 1.9. Menaxhimin dhe organizimin e çmimit "Punimi më i mirë i vitit" & "Vepra artistike më e mirë e vitit";
  - 1.10. Menaxhimin dhe organizimin e çmimit "Hulumtuesi i vitit".

## **Neni 9**

### **Detyrat dhe përgjegjësit e Grupit për Kërkime Shkencore**

1. Grupi për kërkime shkencore dhe veprimtari artistike themelohet me vendim të Rektorit me mandat 4 vjeçar, të cilin e kryeson koordinatori për kërkime shkencore. Ky grup përbëhet nga:
  1. Kryesuesi i grupit – Koordinatori për kërkime shkencore;
  2. Prorektori për Mësimdhënie, Çështje Studentore dhe Kërkime Shkencore
  3. Një përfaqësues i fakultetit të biznesit
  4. Një përfaqësues i fakultetit juridik
  5. Një përfaqësues i fakultetit të menaxhimit në turizëm, hotelieri dhe mjedis
  6. Një përfaqësues i fakultetit të agrobiznesit
  7. Një përfaqësues i fakultetit të arteve
  8. Drejtori për mësimdhënie dhe çështje akademike
  9. Drejtori i bibliotekës
  10. Një përfaqësues nga radhët e studentëve me notë mesatare së paku 8.00.
2. Grupi për Kërkime Shkencore dhe veprimtari artistike është përgjegjës për kategoritë si më poshtë:
  - 2.1. Pranon dhe shqyrton dokumentacionin për përkrahjen e aplikimeve për mbështetje financiare për publikimin e punimeve shkencore në revista ndërkombëtare të indeksuara në WEB OF SCIENCE (SCIE, SSCI, AHCI) dhe SCOPUS (Q1, Q2, Q3, Q4);
  - 2.2. Pranon dhe shqyrton dokumentacionin për përkrahjen e aplikimeve për mbështetje financiare për pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare;
  - 2.3. Pranon dhe shqyrton dokumentacionin për përkrahjen e aplikimeve për projekte të vogla kërkimore vendore dhe rajonale;
  - 2.4. Pranon dhe shqyrton aplikacionet për përzgjedhjen e çmimit "Punimi më i mirë i vitit" & "Vepra artistike më e mirë e vitit";

2.5. Pranon dhe shqyrton aplikacionet për përzgjedhjen e çmimit "Hulumtuesi i vitit" & "Artisti i vitit".

3. Në bazë të dokumentacionit të pranuar dhe të shqyrtuar, Grupi për Kërkime Shkencore dhe veprimtari artistike propozon/nuk propozon për mbështetje financiare për kategoritë si në paragrafin 2 të këtij neni, Këshillit Drejtues të UHZ-së.
4. Grupi për kërkime shkencore dhe veprimtari artistike mbanë 4 (katër) takime të rregullta (mars, qershor, shtator, dhjetor) brenda një viti kalendarik në kuadër të të cilave shqyrton kërkesat e personelit akademik për mbështetje financiare që parashihen në pikat e sipërshënuara. Takimet ftohen dhe kryesohen nga Kryesuesi i Grupit për Kërkime Shkencore.
5. Në rast të mungesës së kryesuesit të Grupit për Kërkime Shkencore mbledhjen e udhëheq anëtari i autorizuar nga kryesuesi.
6. Në rast të mungesës së ndonjërit nga anëtarët në takimet e grupit për kërkime shkencore 2 herë radhazi, pa arsyetim, konsiderohet se anëtari ka hequr dorë nga pozita e të qenurit anëtar i këtij grupi. Zëvendësimi bëhet sipas pikës 1 të këtij neni.

#### **Neni 10** **Instituti i UHZ-së**

1. Instituti për Shkencë dhe Arte në nivel të institucionit përbëhet nga 5 departamente.
2. Puna dhe veprimtaria e institutit rregullohet me rregullore të veçantë.
3. Aktivitetet kërkimore-shkencore dhe artistike në nivel të institutit mbikëqyren nga Këshillat Shkencore të institutit në pajtim me rregulloren e tyre dhe menaxhohet nga drejtori i institutit.
4. Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe artistike nga ana e instituteve realizohet në formë të kërkimeve themelore dhe kërkimeve të aplikuaras si dhe veprimtarive artistike që janë në lidhje të ngushtë me nevojat e interesit publik.
5. Bartësi kryesor i aktivitetit kërkimor-shkencor dhe artistike është personeli akademik i Universitetit i angazhuar në realizim e tij me detyrime individuale apo grupe.
6. Pjesëmarrës në realizimin e këtyre aktiviteteve mund të jenë edhe studentët në bashkëpunim me personelin akademik të rregullt të UHZ-së.

#### **Neni 11**

#### **Mbështetja financiare për publikimin e punimeve shkencore në revista të indeksuara në WEB OF SCIENCE dhe SCOPUS**

1. Personeli akademik i rregullt do të përkrahet financiarisht për publikimin e punimeve shkencore (deri në 3 punime) brenda një viti kalendarik<sup>1</sup> të indeksuara në platformat WEB OF SCIENCE (SCIE, SSCI, AHCI) dhe SCOPUS (Q1, Q2, Q3, Q4), si në vijim:
  - a. Për punimet e publikuara në WEB OF SCIENCE (SCIE, SSCI, AHCI) ofrohet mbështetja në vlerë prej **1,000.00 €**, nëse aplikuesi është autori i parë apo autor korrespondent.
  - b. Për punimet e publikuara në SCOPUS (Q1, Q2, Q3, Q4) ofrohet mbështetja në vlerë prej **800.00 €**, nëse aplikuesi është autori i parë apo autor korrespondent.

---

<sup>1</sup> Grupi për Kërkime Shkencore dhe veprimtari artistike rezervon të drejten që personeli akademik të cilët aplikojnë me më shumë se një punim do të financohen varësisht prej mundësive buxhetore që UHZ disponon.

2. Të drejtë për mbështetje financiare kanë personeli akademik i UHZ-së të cilët janë autorë i parë ose autori korrespondent i atij punimi.<sup>2</sup>
3. Aplikimi për punime shkencore bëhet vetëm për ato punime që publikohen brenda një viti kalendarik apo pretendohet të publikohen deri më 31.12. të atij viti kalendarik;
4. Për 3 punime mund të aplikohet vetëm nga një herë, qoftë nga autori i parë apo ai korrespondent sipas këtyre rregullave:
  - 3.1. Nëse personeli aplikon për mbështetje financiare për 3 punime shkencore, atë mund ta bëjë në periudha të ndryshme kohore:
    - 3.1.1. Për një punim mund të aplikojnë përgjatë tërë vitit kalendarik, ndërsa për më shumë se një punim mund të aplikojnë vetëm në fund të vitit kalendarik.<sup>3</sup>
4. Për të aplikuar për mbështetje financiare për publikimin e punimeve shkencore në revista të indeksuara në WEB OF SCIENCE dhe SCOPUS, duhet të dorëzohen dëshmitë si në vijim:
  - 4.1. Të plotësohet, nënshkruhet dhe protokollohet formulari;
  - 4.2. Të bashkëngjitet dëshmia për publikimin e punimit shkencor në revistën e indeksuara në WEB OF SCIENCE ose SCOPUS;
  - 4.3. Të nënshkruhet deklarata nën betim;
5. Dokumentet duhet të dërgohen në formë fizike në zyrën e protokollit në rektorat.
6. Për punimet shkencore për të cilat është pranuar mbështetja financiare nga institucione tjera në vend, nuk mund të kërkohet mbështetja financiare nga UHZ.<sup>4</sup>
7. Mbështetja ju ofrohet vetëm punimeve që janë të publikuar në revista kredibile.

## Neni 12

### Mbështetja financiare për pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare

1. Personelit akademik të rregullt, UHZ ofron mbështetje financiare për pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare, dhe konferenca shkencore rajonale ndërkombëtare, sipas rregullave si në vijim:
  - a) Të drejtë për mbështetje financiare ka i gjithë personeli akademik i UHZ-së të cilët janë prezantues në konferenca shkencore ndërkombëtare (me pjesëmarrje fizike, në distancë apo prezantim me poster);
  - b) Shuma maksimale për mbështetje financiare për pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare<sup>5</sup> është në vlerë prej **500.00€** (financohet pjesëmarrja në konferencë, akomodimi dhe udhëtimi);
  - c) Shuma maksimale për mbështetje financiare për pjesëmarrje në konferenca shkencore rajonale ndërkombëtare<sup>6</sup> është në vlerë prej **500.00€** (financohet vetëm pjesëmarrja në konferencë);
  - d) Për pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare për të cilat është pranuar mbështetja financiare nga institucione tjera në vend, nuk mund të kërkohet mbështetja financiare nga UHZ.<sup>7</sup>
  - e) Vetëm një herë në vit i njëjti staf akademik mund të kërkojë mbështetje financiare për këtë kategori.

<sup>2</sup> Në rastet kur autori korrespondent nuk është i identifikuar qartë si i tillë në punim atëherë mbështet autorin i dytë.

<sup>3</sup> Për shkak të alokimit të barabartë të mjeteve financiare tek secili anëtar i personelit akademik i cili aplikon.

<sup>4</sup> Me rastin e aplikimit duhet të nënshkruhet deklarata nën betim e cila është pjesë e kësaj rregullore.

<sup>5</sup> Konferencat që mbahen në shtetet me të cilat Kosova nuk kufizohet në kuptimin e kufijve territorial.

<sup>6</sup> Konferencat që mbahen në shtetet me të cilat Kosova kufizohet në kuptimin e kufijve territorial.

<sup>7</sup> Me rastin e aplikimit duhet të nënshkruhet deklarata nën betim e cila është pjesë e kësaj rregullore.

2. Për të aplikuar për mbështetje financiare për pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare, duhet të dorëzohen dëshmitë si në vijim:
  - a. Të aplikohet së paku një muaj para se të mbahet konferenca;
  - b. Të plotësohet, nënshkruhet dhe protokollohet formulari;
  - c. Të bashkëngjitet dëshmia për pranimin e abstraktit;
  - d. Të bashkëngjitet agjenda e konferencës;
3. Rimbursim i mjeteve financiare bëhet pas sjelljes së dëshmisë (**certifikata për pjesëmarrje; pagesa për pjesëmarrje në konferencë**) Grupit për Kërkime Shkencore;
4. Dokumentet duhet të dërgohen në formë fizike në zyrën e protokollit në rektorat.

### Neni 13

#### Mbështetja financiare për projekte kërkimore shkencore/artistike

1. Personelit akademik të rregullt, UHZ ofron mbështetje financiare për projekte kërkimore shkencore/artistike sipas rregullave si në vijim:
  - a) Të drejtë për mbështetje financiare kanë i gjithë personeli akademik i UHZ-së në bashkëpunim me 1 staf nga administrata, dhe së paku 2 studentë, si dhe bashkëpunëtorët e Institutit për Shkencë dhe Arte;
  - b) Projekti duhet të jetë multidisiplinar dhe në interes të institucionit/njesisë akademike, komunitetit dhe industrisë sipas fushave si në vijim:
    - a. Shkenat e biznesit, ekonomisë, financave dhe teknologjisë informative;
    - b. Shkenat sociale;
    - c. Shkenat e turizmit dhe hotelërisë;
    - d. Shkenat e drejtësisë;
    - e. Shkenat e agrobiznesit dhe mjedisit;
    - f. Shkenat artistike –muzikore;
  - c) Shuma maksimale për mbështetje financiare përcaktohet me shpalljen e konkursit (projekt i vogël, projekt i mesëm, projekt i madh);
  - d) Për mbështetje financiare për projekte kërkimore shkencore/artistike për të cilat është pranuar mbështetja financiare nga institucione tjera në vend, nuk mund të kërkohet mbështetja financiare nga UHZ;
  - e) UHZ do të shpall konkurs për projekte kërkimore shkencore/artistike së paku 2 herë<sup>8</sup> brenda një viti kalendarik;
2. Numri i projekteve që do të financohen nga UHZ brenda një viti kalendarik varet nga buxheti i disponueshëm;
3. Aplikimi bëhet në bazë të shpalljes së konkursit;
4. Implementimi i projektit bëhet sipas afatit të caktuar me konkurs;
5. Raportimi i implementimit të projektit bëhet varësisht nga kohëzgjatja e projektit<sup>9</sup>, te Zyra për Kërkime Shkencore;
6. Koordinatorët e projekteve janë përgjegjës për propozim-alokimin e financimit, implementimin dhe menaxhimin financiar të projekteve në përputhshmëri me ligjet, rregulloret/procedurat e Universitetit dhe të projektit;
7. Për të aplikuar për mbështetje financiare për projekte kërkimore shkencore/artistike, duhet:
  - a. Të plotësohet, nënshkruhet dhe protokollohet formulari;
  - b. Të bashkëngjiten CV-të e anëtarëve.
8. Dokumentet duhet të dërgohen në formë fizike në zyrën e protokollit në rektorat.

<sup>8</sup> UHZ shpall konkurs varësisht nga buxheti i disponueshëm.

<sup>9</sup> Nëse projekti zgjat dy vite, atëherë raportimi bëhet çdo 6 muaj.

9. Rezultatet e dala nga këto projekte kërkimore shkencore/artistike do të jenë rezultate kërkimore të Institutit për Shkencë dhe Arte.
10. Në rast të mungesës së aplikimeve, si dhe mos përmbushjes së kriterëve, nga personeli i universitetit, rishpallet konkursi për hulumtuesit e jashtëm.

#### Neni 14

##### Çmimi "Punimi më i mirë i vitit" & "Vepra artistike më e mirë e vitit"<sup>10</sup>

1. UHZ çdo vit ndan çmimin "Punimi më i mirë i vitit" ose "Vepra artistike më e mirë e vitit" për secilën njësi akademike;
2. Punimi më i mirë i vitit brenda vitit kalendarik përzgjidhet nga Grupi për Kërkime Shkencore;
3. Shpërblimi bëhet në vlerë monetare prej **200.00 €**, si dhe në vlerë jo-monetare ndarja e certifikatës;
4. Kriteret për çmimin "Punimi më i mirë i vitit" ose "Vepra artistike më e mirë e vitit" janë:
  - a) Aplikuesi duhet të jetë autor i parë;
  - b) Punimi duhet të jetë i indeksuar në WEB OF SCIENCE (SCIE, SSCI, AHCI) dhe SCOPUS (Q1, Q2);
  - c) Punimi duhet të jetë i publikuar në revistë që ka impakt faktor 2.0 e tutje;
  - d) Punimi duhet të jetë i publikuar në revistën kredibile;
  - e) Punimi duhet të ketë numrin më të lartë të citimeve<sup>11</sup>;
  - f) Punimi duhet të jetë i fushës së aplikuesit;
  - g) Punimi duhet të ofroj njohuri të reja në shërbim të mësimnxënies për student;
  - h) Punimi duhet të ketë kontribut social
  - i) Vepra artistike – Koncert solistik me vlera artistike<sup>12</sup>;
  - j) Vepra artistike e realizuar në arenën ndërkombëtare.
5. Aplikimi për çmimin "Punimi më i mirë i vitit" ose "Vepra artistike më e mirë e vitit" bëhet vetëm një herë në vit në bazë të thirrjes për aplikim e që shpallet në faqe zyrtare më dt. 10.01. – 25.01.;<sup>13</sup>
6. Për të aplikuar për çmimin "Punimi më i mirë i vitit" apo "Vepra artistike më e mirë e vitit", duhet të bashkëngjiten dëshmitë sipas pikës 4 (katër) të këtij neni;
7. Dokumentet duhet të dërgohen në formë fizike në zyrën e protokollit në rektorat.

#### Neni 15

##### Çmimi "Hulumtuesi i vitit" & "Artisti i vitit"

1. Çdo vit kalendarik, UHZ ndan çmimin "Hulumtuesi i vitit" & "Artisti i vitit" për secilën njësi akademike;
2. Hulumtuesin e vitit e përzgjedh Grupi për Kërkime Shkencore;
3. Shpërblimi bëhet në vlerë monetare prej **500.00 €**, si dhe në vlerë jo-monetare ndarja e certifikatës;
4. Përzgjedhja bëhet në bazë të:
  - a) Numrit të punimeve shkencore;
  - b) Numrit të kërkimeve shkencore (si p.sh. studimet post doktorale, apo të ngjashme)

<sup>10</sup> Për personelin akademik nga Fakulteti i Arteve.

<sup>11</sup> Përparësi ka punimi i cili ka citime më shumë.

<sup>12</sup> Koncert me vlera të larta artistike.

<sup>13</sup> Aplikim bëhet për vitin paraprak.

- c) Numrit të librave/kapitujve të botuara;
  - d) Numrit të monografive;
  - e) Numrit të projekteve shkencore/kulturore;
  - f) Numrit të konferencave shkencore ndërkombëtare;
  - g) Numrit të aktiviteteve muzikore ndërkombëtare;
  - h) Numrit të pjesëmarrjes në festivale-koncerte ndërkombëtare.
5. Kriteret për çmimin "Hulumtuesi i vitit" janë:
- a) Aplikuesi duhet të jetë autor i parë ose autor korrespondent;
  - b) Punimet më të cilat aplikon duhet të jenë të indeksuara në WEB OF SCIENCE (SCIE, SSCI, AHCI) dhe SCOPUS (Q1, Q2, Q3, Q4);
  - c) Punimet duhet të jenë të publikuara në revista që kanë impakt faktor më të lartë;
  - d) Punimet duhet të jenë të publikuara në revista kredibile;
  - e) Punimet duhet të kenë numrin më të lartë të citimeve<sup>14</sup>;
  - f) Punimet duhet të jenë të fushës së aplikuesit;
  - g) Punimet duhet të kenë kontribut social;
  - h) Kërkimet shkencore të jenë të fushës së aplikuesit;
  - i) Librat/kapitujt duhet të jenë të fushës së aplikuesit;
  - j) Monografit duhet të jenë të fushës së aplikuesit;
  - k) Projekte shkencore/kulturore duhet të jenë të fushës së aplikuesit;
  - l) Konferencave shkencore ndërkombëtare të jenë të fushës së aplikuesit;
  - m) Aktivitetet muzikore ndërkombëtare;
  - n) Pjesëmarrja në festivale-koncerte ndërkombëtare.
6. Aplikimi për çmimin "Hulumtuesi i vitit" & "Artisti i vitit" bëhet vetëm një herë në vit në bazë të thirrjes për aplikim e që shpallet në faqe zyrtare më dt. 10.01. – 25.01.;<sup>15</sup>
7. Për të aplikuar për çmimin "Hulumtuesi i vitit" & "Artisti i vitit", duhet të bashkangjiten dëshmitë sipas pikës 5 (pesë) të këtij neni;
8. Dokumentet duhet të dërgohen në formë fizike në zyrën e protokollit në rektorat.

## **Neni 16**

### **Mbulimi i shpenzimeve për veprimtari kërkimore-shkencore dhe artistike**

1. Veprimtaria kërkimore-shkencore dhe artistike financohet nga buxheti i UHZ-së për kërkime shkencore dhe veprimtari artistike si dhe nga pjesëmarrja e partnerëve dhe donatorëve të jashtëm bashkëpjesëmarrës në projektet e përbashkëta.
2. Me vijën buxhetore për kërkime shkencore mbulohen:
  1. Botimi i punimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare WEB OF SCIENCE (SCIE, SSCI, AHCI) dhe SCOPUS (Q1, Q2, Q3, Q4);
  2. Pjesëmarrja në konferenca shkencore ndërkombëtare;
  3. Projekte të vogla kërkimore të njëjësive akademike;
  4. Botimi i librave universitar sipas rregullores së veçantë për botime;
  5. Botimi i revistës në nivel të Universitetit;
  6. Botimi i gazetës së studentëve në nivel të Universitetit.
3. Lartësia e mjeteve financiare për veprimtari kërkimore-shkencore dhe artistike caktohet me buxhetin e Universitetit, të miratuar nga Këshilli Drejtues i UHZ-së. Alokimi i mjeteve financiare të parapara në buxhet bëhet sipas prioriteteve të programit vjetor të kërkimeve

<sup>14</sup> Përparësi ka punimi i cili ka citime më shumë.

<sup>15</sup> Aplikim bëhet për vitin paraprak.



shkencore dhe veprimtarive artistike të aprovuar nga Grupi për kërkime shkencore dhe veprimtari artistike.

4. Grupi për Kërkime Shkencore i raporton Rektorit për realizimin e mjeteve buxhetore për kërkime shkencore dhe veprimtari artistike.

#### **Neni 17**

#### **Masat ndëshkuese për pasivitet në punën kërkimore-shkencore dhe artistike**

1. Pasiviteti i personeli akademik brenda një vit akademik për aktivitetet kërkimore-shkencore dhe artistike mund të ndëshkohet në forma të cilat janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Dekani i njësisë akademike mund të ndërmarrë këto masa:
  - 1.1. Shqiptimin e vërejtjes verbale;
  - 1.2. Shqiptimin e vërejtjes me shkrim;
  - 1.3. Ngarkimin me detyra shtesë sipas nevojave të njësisë akademike; dhe
  - 1.4. Masat e tjera të parapara me legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 18**

#### **E Drejta e Ankesës**

Kundër vendimeve të Grupit për Kërkime Shkencore, personeli akademik ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh kalendarike, nga dita e pranimit të vendimit duke ju drejtuar komisionit për ankesa dhe parashtresa në kuadër të Këshillit Drejtues të UHZ – së, që shërben si shkallë e parë dhe e fundit brenda UHZ – së.

#### **Neni 19**

#### **Shtojcat**

Zbatimi i kësaj rregulloreje bëhet konform procedurave të dhëna në SHTOJCAT që janë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

#### **Neni 20**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për veprimtarinë kërkimore-shkencore ref.nr. 2862/23, e datës 03.10.2023.

#### **Neni 21**

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratim nga Senati.



**Kryesuesi i Senatit**  
**Prof. Dr. Armand Krasniqi**

**SHTOJCAT**

**GRUPI PËR KËRKIME SHKENCORE**

Pejë, dt.

---

**Deklaratë nën betim**

Unë \_\_\_\_\_ deklaroj nën betim më përgjegjësi etike, morale dhe disiplinore se për këtë punim për të cilin po aplikoj për mbështetje financiare pranë grupit për kërkime shkencore në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, nuk jam mbështetur financiarisht nga ndonjë institucion tjetër.

**Nënshkrimi i aplikuesit**

---



Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë

**Formulari për aplikim për mbështetje financiare për publikimin e Punimeve Shkencore në Revista Shkencore / Pjesëmarrje në Konferenca Shkencore Ndërkombëtare**

**Informata për aplikuesit**

Emri dhe mbiemri	
Data e lindjes	
Titulli/grada shkencore	
Njësia akademike (UHZ)	
Fusha(t) e specializimit hulumtues	
Posta elektronike	
Numri i telefonit	

**Informata për punimin shkencor**

Emri i punimit	
Autori/ët e punimit	
Roli i aplikuesit në punim (në revistë shkencore)	<input type="checkbox"/> Autor i parë <input type="checkbox"/> Autor korrespondent
Emri i revistës	
Indeksi i revistës <sup>16</sup>	
Vegëza për tek faqja informuese për revistën	
A jeni mbështetur financiarisht nga ndonjë institucion tjetër vendor? Nëse po, specifikoni.	

<sup>16</sup> Vetëm punimet e publikuara në revista të indeksuara në WEB OF SCIENCE dhe SCOPUS do të mbështeten.

**Informata për konferencën shkencore ndërkombëtar /performancën artistike**

<b>Titulli i konferencës shkencore/performancës artistike<sup>17</sup></b>	
<b>Autorët e punimit/performancës artistike<sup>18</sup></b>	
<b>A) Roli i aplikuesit në performancën artistike</b>	<input type="checkbox"/> Solist <input type="checkbox"/> Mysafir <input type="checkbox"/> Korepetitor
<b>B) Roli i aplikuesit në konferencë</b>	<input type="checkbox"/> Prezantues i punimit në konferencë
<b>Vegëza për tek faqja informuese për konferencën apo performancën</b>	
<b>A jeni mbështetur financiarisht nga ndonjë institucion tjetër vendor? Nëse po, specifikoni.</b>	

**Nënshkrimi i aplikuesit**

\_\_\_\_\_

<sup>17</sup> Konferencat dhe performancat e realizuara në vendet fqinje të Kosovës, nuk do të mbështeten.

<sup>18</sup> Nëse aplikoni për mbështetje të pjesëmarrjes në performancë artistike, plotësoni njërin nga opsionet në rubrikën A. Nëse aplikoni për mbështetje të pjesëmarrjes në konferencë shkencore, plotësoni rubrikën B.



Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë

Formulari për aplikim për projekt kërkimor për Njësi Akadematike të UHZ-së

**Pjesa I: Administrimi<sup>19</sup>**

Titulli i projektit	
Kohëzgjatja e projektit (në muaj)	
Njësia Akadematike e UHZ-së që aplikon	
<b>Të dhënat për ekipin hulumtues të projektit hulumtues</b>	
<b>Të dhënat për Dekanin e Njesisë Akadematike</b>	
Emri i Dekanit	
Vendi	
Numri i telefonit	
Posta elektronike	
Faqja e internetit/rrjeti social	

**Shënim:** Financimi do të bëhet në euro (€).

<b>Të dhënat për anëtarët e ekipit hulumtues</b>	
<b>Anëtari 1</b>	
Emri dhe mbiemri	
Titulli/Grada shkencore	

<sup>19</sup> Ky formular nuk vlen për pikat 4.2.2 dhe 4.2.3 të Planit Strategjik të UHZ-së 2020-2024

Njësia Akademike brenda UHZ-së	
Numri i telefonit	
Posta elektronike	
Fusha e specializimit hulumtues	
Kontributi në projekt	

**Anëtari 2**

<b>Anëtari 2</b>	
Emri dhe mbiemri	
Ditëlindja	
Titulli/Grada shkencore	
Njësia Akademike brenda UHZ-së	
Numri i telefonit	
Posta elektronike	
Fusha e specializimit hulumtues	
Kontributi në projekt	

**Anëtari 3**

<b>Anëtari 3</b>	
Emri dhe mbiemri	
Ditëlindja	
Titulli/Grada shkencore	
Njësia Akademike brenda UHZ-së	

Numri i telefonit	
Posta elektronike	
Fusha e specializimit hulumtues	
Kontributi në projekt	

<b>Anëtari 4</b>	
Emri dhe mbiemri	
Ditëlindja	
Titulli/Grada shkencore	
Njësia akademike brenda UHZ-së	
Numri i telefonit	
Posta elektronike	
Fusha e specializimit hulumtues	
Kontributi në projekt	

**Shënim:** Shtoni tabela si këto të mësipërme, varësisht nga numri i anëtarëve.

**Pjesa II: Informacione rreth projektit**

**Përshkrim gjithëpërfshirës shkencor i projektit (300 – 500 fjalë)**

*Pasqyrë e shkurtër e projekt-propozimit tuaj: Çfarë synohet të studiohet? Cilat janë objektivat dhe qëllimi? Cilat janë pyetjet hulumtuese, metodat dhe qëndrueshmëria e projektit?*

Fjalë kyçe për projektin (6 max.)



### **Plani i hulumtimit/realizimit të projekt-propozimit (1-2 faqe)**

*Përmendni dhe ritheksoni objektivat dhe qëllimet e projekt-propozimit, metodat e hulumtimit, të dhënat në dispozicion dhe/ose të dhënat për t'u mbledhur. Kush nga ekipi hulumtues do të udhëheq/ndërmerr pjesë të ndryshme të projektit?*

1. Titulli
2. Fushat tematike
3. Objektivat dhe synimet kryesore
4. Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve
5. Ndarja e punës në mes të anëtarëve të ekipit hulumtues

**Ndikimi dhe qëndrueshmëria e projektit (max. 1 faqe)**

*Pse është i rëndësishëm ky projekt hulumtues? Cili është ndikimi i projektit në dobi të fushës së studimit, në dobi të UHZ-së, apo në dobi të shoqërisë në përgjithësi?*

### Plani i punës dhe afatet kohore

Paraqitni një plan **sa më të hollësishëm** të punës (në formë tabelare) duke përfshirë aktivitetet që parashihen të ndërmerren në këtë projekt, afatet kohore për secilin nga këto aktivitete, personat përgjegjës për realizimin e aktivitetit dhe koston e lidhur me aktivitetin.

### III. Arsyetimi financiar

**Plani i përgjithshëm buxhetor**

Kosto totale e projektit (EUR)	
Shuma e kërkuar nga UHZ (EUR) (100%) <sup>20</sup>	
Prej së cilave:	
Kosto materiale (Pajisje, produkte, etj.) (40%)	
Kosto administrative (udhëtime, takime, shpenzime ditore, etj.) (30%)	
Kosto të personelit <sup>21</sup> (studentë, ekspertë apo konsulentë të jashtëm) (20%)	
Kostot e tjera (10%)	

**Përshkrimi i detajuar i kostos<sup>22</sup>**

Kostot e projektit preferohet të shpërndahen në: 40% kosto materiale, 30% kosto administrative, 20% kosto të personelit dhe 10% kostot e tjera.

<b>PËRSHKRIMI I KOSTOS</b>	<b>SASIA</b>	<b>KOSTO TOTALE</b>
<b>Kosto materiale (40%)</b> (Në rubrikat e mëposhtme, përshkruani më detajisht kostot materiale; p.sh. blerja e xx pajisjeve)		
<b>Kosto administrative (30%)</b> (Në rubrikat e mëposhtme, përshkruani më detajisht kostot administrative: p.sh. udhëtimi, takimet, etj.)		

<sup>20</sup> Me një arsyetim të bazuar, këto përqindje mund të ndryshohen.

<sup>21</sup> Mëditjet për personelin e brendshëm (UHZ) të projektit nuk mbulohen.

<sup>22</sup> Dëshmitë e kostove të projektit duhet të ruhen dhe të raportohen në fund të projektit.

<b>Kosto e personelit (20%)</b> (Në rubrikat e mëposhtme, përshkruani më detajisht kostot e personelit: p.sh. angazhimi i konsulentëve, ekspertëve, studentëve, etj.)		
<b>Kostot e tjera (10%)</b> (Në rubrikat e mëposhtme, përshkruani më detajisht kostot e tjera që përfshihen në projekt)		
Kosto totale (100%)	/	€

Nënshkrimi i aplikuesit

\_\_\_\_\_

### VLERËSIMI I PROJEKTIT NË PIKË

AKTIVITETI	PIKËT
------------	-------

<b>Përshkrim gjithëpërfshirës shkencor i projektit (20 pikë)</b>	
<b>Plani i hulumtimit/realizimit të projekt-propozimit (20 pikë)</b>	
<b>Ndikimi dhe qëndrueshmëria e projektit (30 pikë)</b>	
<b>Plani i punës dhe afatet kohore (10 pikë)</b>	
<b>Arsyetimi financiar (20 pikë)</b>	
<b>Gjithsej (100 pikë)</b>	

## RAPORT

për implementimin e projektit kërkimor<sup>23</sup>

<b>Titulli i projektit:</b>	
<b>Bashkëpunëtorët e projektit:</b>	
<b>Data e aprovimit të projektit:</b>	
<b>Data e transferimit të mjeteve financiare:</b>	
<b>Data e fillimit të implementimit të projektit:</b>	
<b>Progresi i projektit:</b>	
<b>Data e përfundimit të projektit:</b>	

Nënshkrimi i koordinatorit të projektit

---

### Definicionet dhe kriteret për financimin e projekteve të brendshme

1. Definicionet e termeve dhe kriteret, të cilat aplikohen në financimin e projekteve, janë si vijon:

---

<sup>23</sup> Ky formular përdoret për raportimin e projektit.

- 1.1. "Kosto materiale" i referohet kostos për pajisje të ndryshme zyre ose laboratorike për realizimin e projektit për të cilin mund të alokohet më së shumti 40% nga buxheti i projektit.
- 1.2. "Kosto administrative" i referohet honorarit për administrim ose për koordinimin e projektit dhe harxhimeve për materiale zyre dhe të ngjashme, për të cilin mund të alokohet më së shumti 30% nga buxheti i projektit;
- 1.3. "Kosto e personelit" i referohet pagesave për konsulent të jashtëm dhe studentë të përfshirë në projekt, për të cilin mund të alokohet deri në 20 % nga buxheti i projektit;
- 1.4. "Kosto të tjera" i referohet shpenzimeve të tjera të nevojshme për realizimin e projektit, por që nuk janë paraparë në kategoritë e lartpërmendura, për të cilën mund të alokohen më së shumti 10%.